



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KUKËS

Kukës, më 25.11.2024

NJOFTIM

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE TË PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR
PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESISË (PERIUDHA II)**

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kukës, njofton të gjithë studentët dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet në fushën e edukimit (mësuesisë) të aplikojnë për regjistrimin në praktikën profesionale, periudha II, për vitin shkollor 2024-2025, nëpërmjet platformës e-albania.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesisë, duhet të kenë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë dhe programin e studimit të ciklit të dytë (Master i Shkencave/Master i arteve të Bukura/Master Profesional) në Fushën e Edukimit, që përmban lëndët Pedagogji dhe Psikologji.

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania për periudhën e dytë është nga data 02.12.2024 – 13.02.2024

Kandidati duhet të ngarkojë në platformën e-albania këto dokumenta:

1. Jetëshkrimi/ CV e praktikantit
2. Dokumenti i identifikimit (Kartë Identiteti)
3. Diploma dhe lista e notave e ciklit të parë të studimeve (Bachelor)
4. Diploma dhe lista e notave e ciklit të dytë të studimeve (Master Shkencor/ Profesional në mësuesu)
5. Raport mjeko-ligjor
6. Vetëdeklarimi igjendjes gjyqësore
7. Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata se nuk është në procedim penal
8. Vërtetim banimi

Dokumentet e përcaktuara janë të detyrueshme dhe duhet të jenë të skanuara nga origjinali.

Faleminderit dhe suksese!

DREJTOR
KRESHNIK GERBOLLI

